



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 02.10.2019

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10304, DATË 15.7.2010, “PËR
SEKTORIN MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime, në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, në mbledhjen e datës 2 tetor 2019.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Andrea Marto relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishte z. Ilir Bejtja, zëvendësministër në ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa ndryshime, në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Ndryshimet që propozon ky projektligj paraqiten në kuadër të reformës së deregulimit, e cila ka për qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative.

Qëllimi i propozimit të këtyre ndryshimeve është krijimi i lehtësirave për ushtrimin e lirë të veprimtarisë studimore-projektuese në fushën minerare, ndërhyrje që do të mundësojë reduktimin e barrierave administrative, duke sjellë kështu përmirësimin e klimës së biznesit.

Në këtë kuadër, projektligji propozon shfuqizimin e licencës “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare, me kodin IV.4.A”.

Me shfuqizimin e kësaj licence, ushtrimi i veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare do të jetë i lirë dhe do të kryhet vetëm nga subjektet e certifikuar për këtë qëllim.

Sipas projektligjit, veprimtaria studimore -projektuese në fushën minerare do të ushtrohet vetëm nga subjektet, persona fizikë, të certifikuar, të cilët e kanë të regjistruar këtë objekt veprimtarie në regjistrin tregtar, ose nga persona juridik, të cilët kanë të punësuar individë të certifikuar.

Lidhur me impaktin që do të kenë ndryshimet e propozuara, mund të thuhet se ato do të ndikojnë në reduktimin e numrit të nevojshëm të licencave për veprimtarinë studimore minerare për personat juridik, shkurtimin e kohës së ushtrimit të kësaj veprimtarie si dhe në përshpejtimin e vënies në dispozicion të projektit, shoqërive që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mineraleve.

Projektligji nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

Për zbatimin e tij ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin përkatës që rregullon këtë fushë në vendet anëtare të BE-së.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 4 nene.

- ***Konsultimi publik***

Referuar relacionit që shoqëron projektligjin, rezulton se në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ky projektligj i është nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik (RENJK), por përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se nuk ka pasur komente apo sugjerime nga grupe interesi.

Në respektim të parimit të transparencës dhe të gjithëpërfshirjes, mbi të cilat zhvillohet veprimtaria parlamentare, bazuar në përcaktimet e nenit 36 të Rregullores së Kuvendit, si dhe në kërkesën e “Shoqatës së Minierave të Shqipërisë”, Komisioni zhvilloi një séance dëgjimore me përfaqësues të kësaj shoqate.

Në fjalën e tij, presidenti i shoqatës, z. Adhurim Çausi, adresoi shqetësimin e industrisë minerare, duke kërkuar një ndryshim në ligjin “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht në nenin 41, pika 1 të tij.

Ky nen përcakton se lejet minerare, të dhëna sipas procedurave konkurruese dhe ato për të cilat është përfunduar një marrëveshje lehtësuese, nuk janë të transferueshme, ndërsa lejet e tjera minerare që nuk janë dhënë me procedurë konkurruese (të dhëna përpara miratimit të ligjit) mund të transferohen, pas marrjes së miratimit paraprak nga ministri.

Ky kufizim është vendosur për të shmangur rastet në të cilat një shoqëri merr pjesë në një procedurë konkurruese për të fituar të drejtat minerare, me qëllim për t'i shitur më pas.

Kufizimi i transferimit të lejeve ka bërë që një pjesë e madhe e tyre të mbeten në fuqi me një aktivitet minimal, për shkak të ndryshimit të situatave ligjore, financiare, tregtare etj, të subjekteve mbajtëse të tyre, të cilat kanë bërë të pamundur vijimin e investimeve. Për shkak të detyrimit ligjor për kthimin e lejes shtetit, në rast të pamundësisë së shfrytëzimit të saj, por duke mos marrë mbrapsht investimin e kryer, shumë subjekte janë përpjekur të gjejnë mënyra të tjera, indirekte nëpërmjet mekanizmit ligjor të shitjes së kuotave të shoqërisë.

Për të bërë të shfrytëzueshme lejet minerare të dhëna, për të evituar mbajtjen pezull të tyre nga operatorët ekzistues, duhet të krijohen hapësira të reja për hyrjen e operatorëve të rinj në treg.

Për këtë qëllim, shoqata propozon ndryshimin e pikës 1 të nenit 41, duke i bërë të transferueshme lejet minerare, të dhëna sipas procedurave konkurruese, nëse kanë kaluar jo më pak se 5 vjet nga miratimi i lejes, pas miratimit paraprak të ministrit.

- ***Diskutimi në Komision***

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komision, deputetët vlerësuan nismën e propozuar dhe kërkuan shpjegime nga propozuesit lidhur me: nevojën e kryerjes së ndryshimeve; impaktin që do të kenë ato; përfshirjen e institucioneve dhe ekspertëve nga bota akademike; kriteret që do të vendosen për t'u pajisur me certifikatë; strukturën që do të bëjë vlerësimin e përmbushjes së kriterëve për certifikim dhe autoritetin që do të bëjë certifikimin e subjekteve.

Përfaqësuesit e ministrisë shpjeguan se ndryshimet që propozon ky projektligj paraqiten në kuadër të reformës së deregulimit, e cila ka për qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative.

Nevoja e bërjes së ndryshimeve në ligjin 10304/2010, është identifikuar gjatë analizës së kryer në kuadër procesit të deregulimit, ku janë analizuar të gjitha licencat dhe lejet e përfshira në Aneksin 1 dhe 2, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

Në përfundim të kësaj analize është vlerësuar se licencimi i subjektit juridik, në këtë rast, është një dokumentacion formal, që shton një hallkë të tepërt licencimi, pasi, edhe pse, sipas përcaktimeve të ligjit, është personi juridik ai që pajiset me licencë, në fakt, studimi kryhet nga personi fizik i licencuar për këtë fushë studimi.

Për këtë arsye, është propozuar shfuqizimi i kësaj licence, duke hequr detyrimin e subjekteve për t'u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare dhe zëvendësim i saj me një “certifikatë”.

Lidhur me impaktin që do të kenë ndryshimet e propozuara, mund të thuhet se ato do të ndikojnë në reduktimin e numrit të nevojshëm të licencave për veprimtarinë studimore minerare për personat juridik, shkurtimin e kohës së ushtrimit të kësaj veprimtarie si dhe në përshpejtimin e vënies në dispozicion të projektit, shoqërive që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mineraleve.

Lidhur me procedurën, kriteret që do të vendosen për t'u pajisur me certifikatë, strukturën që do të bëjë vlerësimin e përmbushjes së kriterëve për certifikim dhe autoritetin që do të bëjë certifikimin e subjekteve, kjo do të jetë pjesë e Vendimit të Këshillit të Ministrave që do të hartohet në zbatim të pikës 3 të nenit 2 të ligjit.

Anëtarët e Komisionit diskutuan edhe lidhur me propozimin e paraqitur nga presidenti i shoqatës së minierave, lidhur me ndryshimin e pikës 1 të nenit 41 të ligjit.

Relatori u shpreh se qëndrimi i shoqatës është i drejtë, por se Komisioni nuk është gati për t'u shprehur mbi këtë propozim pa marrë paraprakisht edhe mendimin e arsyetuar të ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili duhet të vijë i materializuar në formën e një nisme ligjore të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve të Rregullores së Kuvendit.

Edhe përfaqësuesit e ministrisë u shprehën se u nevojitet kohë për ta shqyrtuar teknikisht propozimin e shoqatës së minierave, në mënyrë që të japin një vlerësim të saktë lidhur me mundësinë e bërjes së këtij ndryshimi.

- ***Ndryshime të projektaktit***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni, miratoi vërejtjet si më poshtë:

1. Neni 3 i projektligjit të riformulohet si vijon:

“Neni 3

Dispozitë kalimtare

Licencat aktuale për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare, të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, ruajnë vlefshmërinë e tyre deri në përfundim të afatit për të cilin janë lëshuar”.

RELATOR

Andrea MARTO

KRYETAR

Niko PELESHI